



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**  
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL XII/2021**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 12 (dymbëdhjetë) të rregullt për vitin 2021 të  
Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi:                   Suharekë  
Zyra:                   Salla e Kuvendit të Komunës  
Data:                   14.12.2021  
Ora:                   10.00

---

**Prezentë në takim:**

Të pranishëm të tjerë

Z. Shefket Kolgeci	Znj. Afërdita Morina	
Z.Selman Kolgeci	Z. Enver Shabani	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyqi	Z. Driton Maliqaj	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Z. Xhevxhet Gashi	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Edon Sadikaj	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Dardan Berisha	Z.X heladin sadikaj
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Bexhet Kuçi	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Reshat Selimaj	Z.Liridon Fondaj	
Z. Lirim Qatani	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Aziz Bytyqi	Znj.Festë Kabashi	
Znj.Sanije Kuçi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Besa Kuçi	Znj. Jehona Rrafshi	
Znj.Fidaije Kukaj		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komiteteve të përhershëm të Kuvendit të Komunës;**
- 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarë;**
- 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Komunitete me anëtarë;**

**Kryesuesi** - përshëndet të pranishmit,dhe kërkon që të futet si pikë shtesë dhënia e betimit të anëtarit të ri i cili është zëvendësuar nga PDK-ja.

**Kryesuesi** - e hedh në votim.

**Miratohet Unanimisht**

**Kryesuesi** - i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

**Miratohet Unanimisht**

**Pika shtesë.**

Dardan Berisha jep deklaratën e betimit.

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim

**Miratohet Unanimisht**

**Pika2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komiteteve të përhershëm të Kuvendit të Komunës;**

**Kryesuesi** - të nderuar anëtar, kërkohet që të nxirret vendimi për themelimin e Komiteteve:Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe Komiteti për Komunitete.Numri i ulëseve në këto komite është i paraparë 5 - 7 ulëse.

**Kryesuesi** - e hap debatin.Pasi nuk ka debat, e hedh në votim pikën 2 për 7 ulëse.

**Miratohet Unanimisht**

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarë;**

**Kryesuesi** - Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të ketë 7 anëtarë dhe kjo shkon në bazë të përqindjeve të fituara të partive politike, të ulëseve në Kuvned.

**Avni Bytyqi** - jep sqarime si zyrëtar ligjor. Në bazë të ligjit për vetqeverisje lokale dhe udhëzimit administrativë të MPL-së, përbërja e KPF-së duhet të reflektojë të gjitha etnititetet politike në KPF, mirëpo në ulëse shkon sipas përqindjes që kanë fituar ulëset në Kuvend. KPF do të ketë këtë përbërje: 3 ulëse do ti ketë AAK, 2 ulëse LDK, 1 ulëse PDK dhe 1 ulëse LVV, ndërsa subjektet tjera nuk mund të arrijnë pragun që të fitojnë ulëse në KPF. Lus të gjitha subjektet politike që të propozojnë anëtarët edhe nga gjinia femërore edhe nga gjinia mashkulllore që ky komitet të jetë në harmoni më ligjin për barazi gjinore.

**Kryesuesi** - kërkon propozimet për anëtarët e KPF-së nga partitë politike.

**Reshat Selimaj** - përshtendet të pranishmit. Grupi parlamentar i AAK-së propozon Bexhat Kuçin, Sanie Kuçi-Rexhepaj dhe Aziz Bytyqin.

**Alban Berisha** - grupi parlamentar i LDK-së propozon Urim Sukën dhe Bulëza Kuçin.

**Bajram Basha** - grupi parlementar i PDK-së propozon Dardan Berishën.

**Qëndrim Elshani** - grupi parlementar i LVV-së propozon Liridon Fondaj.

**Kryesuesi** - nuk është struktura e barazisë gjinore dhe ky vendim na kthehet nga Pushteti Lokal. Kërkon nga opozita që ta gjejnë një kompromis mes vete.

**Avni Bytyqi** - si zyrëtar ligjor jep sqarime shtesë.

**Laureta Tafa** - LVV mbetet me të nejtin propozim.

**Dardan Berisha** - Përshtendet të pranishmit. Në bazë të përqindjes së votave grupi parlamentar më i madhë ose gr.parlamentar më i vogël, i bie që të lëshojë pe.

**Kryesuesi** - i jep fjalën zyrëtarit ligjor.

**Avni Bytyqi** - meqë të dy subjektet politike e kanë nga një përfaqësues në KPF, propozoj që të jetë me rrotacion. Ai jep sqarime më tej.

**Kryesuesi** - a jeni të pajtimit?

**Dardan Berisha** - ndoshta gaboj, por mund të jetë një përqindje e vogël që kanë ekonomista, që i takojnë atij profesioni dhe në këtë rast i takon LVV me reflektu.

**Laureta Tafaj** - unë thashë: nuk duhet patjetër ta qojmë një femër. Duhet ta dërgojmë një që i takon atij profesioni dhe që e njeh më mire atë punë.

**Reshat Selimaj** - le të mbetet në procesverbal që ne si subject politikë kemi propozuar 50/50.

**Kryesuesi** - pyet Liridon Fondaj për ndonjë mendim.

**Liridon Fondaj** - jo, ne e kemi mendimin tone. Le të kthehet, le ta rregullojnë ata.

**Kryesuesi** - ne duhet ta rregullojmë dhe jo ata.

**Liridon Fondaj** - pasi keni kualicion me PDK-në, bëjeni një marrëveshje.

**Kryesuesi** - jep përgjigje.

**Jehona Rrafshi** - propozon që të vendoset në votim dhe me vota të vendoset se te kush do të jetë ndryshimi.

**Kryesuesi** - propozon 15 min. pauzë për arritjen e një marrëveshje.

**Kryesuesi** - meqenëse subjektet politike LVV dhe PDK nuk po reflektojnë, atëherë AAK lëshon pe, dhe në vend të Aziz Bytyqit në KPF hyn Besa Kuçi.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2 me emrat e të propozuarve që u dhanë.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Komunitete me anëtarë;**

**Kryesuesi** - edhe ky komision ka përbërjen prej 7 anëtarëve,3 nga subjektet politike (2 AAK dhe 1 LDK ) dhe 4 vinë nga përfaqësues të minoriteteve.

**Kryesuesi** - nga AAK kemi Afërdita Mamaj dhe Aziz Bytyqi.

**Urim Suka** - LDK-në e përfaqëson Doruntina Zenelaj.

**Avni Bytyqi** - te përfaqësuesit e minoriteteve kanë ardhë propozimet nga vet përfaqësuesit,dhe janë:Melisa Shabanaj PDAK, Zek Berisha ROM, Denis Sofra PAI dhe Nazim Shabanaj PE.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4 me emrat e anëtarëve që u propozuan.

**Miratohet Unanimisht**

Takimi përfundoi: **10:40**

**Procesmbajtësja:**  
Dafina Haziraj